

**Njoftim për përqendrim me të cilin AZ DEOS, përkujdesje për të moshuar, sh.p.k.,
Slloveni, do të fitojë kontroll mbi SHKOLLËN E LARTË PËR KONTABILITET DHE
FINANCA, LJUBLJANË, Slloveni
(lënda nr. 08-102/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.06.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka pranuar njoftim për përqendrim me të cilin AZ DEOS, përkujdesje për të moshuar, sh.p.k., me seli në rr. Fajfarjeva nr. 33, 1000, Republika e Sllovenisë, do të fitojë kontroll mbi Shkollën e Lartë për Kontabilitet dhe Financa, Lubjanë, me seli në rr. Stegne 21C, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

AZ DEOS, përkujdesje për të moshuar, sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar më 16.07.2021, me veprimtari kryesore – shërbime të tjera konsulente sipërmarrëse dhe afariste, kryesisht në fushën e mbrojtjes sociale.

AZ DEOS, përkujdesje për të moshuar, sh.p.k., përbën pjesë përbërëse të Grupit PRVA CAP, përkatësisht pronarët e saj janë njëkohësisht pronarë të PRVA FINANCE sh.p.k. (PRVA Finance d.o.o.), e cila është pronare e SKUPINA PRVA SHA, e cila nga ana tjetër është pronare e dy shoqërive në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Shoqëria për sigurim PRVA ZHIVOT SHA Shkup, me seli të regjistruar në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6-1, kati 2, Shkup, me veprimtari prioritare – sigurim jete dhe
- KB Prvo, shoqëri për menaxhim të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup, me seli në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, Shkup, me veprimtari prioritare – menaxhim me fonde.

Shkolla e Lartë për Kontabilitet dhe Financa është institucion privat i arsimit të lartë, që ushtron veprimtari të institucioneve private të arsimit të lartë, përkatësisht arsim të lartë privat në fushën e kontabilitetit dhe financave.

Institucioni Shkolla e Lartë për Kontabilitet dhe Financa nuk ka shoqëri të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet nga palët e treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë pranë Komisionit brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

17.06.2025
Shkup